



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Korrik 2026

Data 30.07.2026 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.06.2026 dhe datë 17.07.2026 si dhe informacion për VKB-të e marra në këto mbledhje.

2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2026.

3.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.74 datë 23.12.2025"Për shtesën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, sipas aktit normativ nr. 2 date 30.06.2026"për dis andryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 Për buxhetin e vitit 2026.

4.Projekt vendim për "Miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës".

5.Projekt vendim për "Miratimin e pranimit të grantit të akorduar nga UNDP për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, si dhe për miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me VKB nr. 74, datë 23.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës"

6.Projekt vendim për" Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 "Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025"

7.Projekt vendim për miratimin në parim të dhënies së drejtës së përdorimit të pasurive të paluejtshme shtetërore,sipas gjurmes së projektit të miratuar që bie në territorin e Bashkisë Vau Dejës për zhvillimin të projektit "Parku i integruar eolik dhe fotovoltaiK Kirac"me statusin e "investitorit strategjik".

8.Projekt vendim për miratimin e njohjes si posedues jopranarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me Vkm nr.780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës.

9.Projekt vendim për"Miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirave publike në territorin Administrativ të Bashkisë Vau Dejës sipas tekstit bashkëlidhur, në zbatim të VKM-së nr 224, datë 01.04.2026, "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike".

10.Projekt vendim për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit të znj. Matilda Terziu në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë"

11.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 30.07.2026 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 20 këshilltarë (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Franga Kola, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Gjon Marku, Florin Tanushi, Pjeter Lleshi, Besmir Kapaj, Rita Preçi, Kastriot Shkjau, Ermir Tahiri, Mirela Vasija, Albina Livadhi, Vjollcë Zagani, Gjovana Corri, Sanije Salja, Mark Bisha, Elton Frashnaj) korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites. Pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me propozimin. Këshilltarët shprehen dakortësi. Hidhet në votim rendi i ditës: **Miratohet me 20 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro: (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Franga Kola, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Gjon Marku, Florin Tanushi, Pjeter Lleshi, Besmir Kapaj, Rita Preçi, Kastriot Shkjau, Ermir Tahiri, Mirela Vasija, Albina Livadhi, Vjollcë Zagani, Gjovana Corri, Sanije Salja, Mark Bisha, Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.06.2026 dhe datë 17.07.2026 si dhe informacion për VKB-të e marra në këto mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 29.06.2026 dhe datës 17.07.2026 nga Z.Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro : (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Franga Kola, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Gjon Marku, Florin Tanushi, Pjeter Lleshi, Besmir Kapaj, Rita Preçi, Kastriot Shkjau, Ermir Tahiri, Mirela Vasija, Albina Livadhi, Vjollcë Zagani, Gjovana Corri, Sanije Salja, Mark Bisha, Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken 2 të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2026.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relatton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Qershor 2026 familje 121, me 395,485 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Qershor 2026 janë shpallur fitues, 859 familje, me fond 6,616,494 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 396,989 lekë.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët.

Znj.Sanije Salja pyet: Janë 2 pensioniata në fshatin Melgushë, kane aplikuar per te perfitur nga fondi 6% dhe janë skualifikuar, pse?.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Znj.Elidona Lisi përgjigjet:Për të gjitha rastet e aplikimeve të cilat bëhen për të perfituar nga fondi I kushtezuar deri në 6% bëhen në system dhe kush nuk i ploteson kushtet, skualifikohet nga sistemi duke pasë parasysh kriteret.

Pyetje tjera nuk ka.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 20 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 2 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj,Meliha Zyberaj,Franga Kola.Frano Prenga,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Gjon Marku,Florin Tanushi,Pjeter Lleshi,Besmir Kapaj,Rita Preçi,Kastriot Shkja,Ermir Tahiri,Mirela Vasija,Albina Livadhi,Vjollcë Zagani,Gjovana Corri,Saniqe Salja,Mark Bisha,Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken 3 të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.74 datë 23.12.2025"Për shtesën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, sipas aktit normativ nr. 2 date 30.06.2026"për dis andryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 Për buxhetin e vitit 2026.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Elsa Tanishi-Drejtore e zyres financë buxhetit Bashkia Vau Dejës, e cila spjeron se është konsideruar që për programin 03280 "Mbrojta nga zjarri dhe mbrojtja civile" mesatarisht gjatë viteve 2023-2025 kemi pas shpenzime shtesë për paga dhe sigurime si pasojë e oreve shtesë që kanë punuar punonjësit e zjarrefiksës ne periudhen verore në një vlerë mesatare prej 1,480,000 lekësh në vit dhe nisur nga kjo, transfertën sektoriale më vlerë prej 1,550,000 lekësh propozohet te kaloje për shpenzime për paga dhe sigurime. Kjo ne kuader te ketij shpenzimi te pritshem per vitin 2026, te bazuar ne historikun e tre viteve te fundit.

Ndërsa fondin e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme me vlerë prej 1,166,904 lekësh propozohet të kaloje për shpenzime korente, llogaria ekonomike 602, për programin buxhetor 06260 "Shërbimet publike vendore", pasi nevojat për realizim shpenzime mirëmbajtje të zakonshme për shërbime janë gjithmonë të pranishme dhe ne rritje konsideruar amortizimin ne rritje.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 3 të rendit të ditës:**Miratohet me 19 vota Pro,1 votë abstenim, zero vota kundër,**Këshilltarët që votuan Pro piken e 3 të rendit të ditës(Ervis Shimaj,Meliha Zyberaj,Franga Kola.Frano Prenga,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Florin Tanushi,Pjeter Lleshi,Besmir Kapaj,Rita Preçi,Kastriot Shkja,Ermir Tahiri,Mirela Vasija,Albina Livadhi,Vjollcë Zagani,Gjovana Corri,Saniqe Salja,Mark Bisha,Elton Frashnaj).Z.Gjon Marku votoj abstenim.

Z.Ervis Shimaj lexon piken 4 të rendit të ditës:

Projekt vendim për "Miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Vau Dejës".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Elsa Tanushi-Drejtore e zyres financë buxhetit Bashkia Vau Dejës, e cila spjeron se të ardhurat e veta të Bashkisë te kategorizuar sipas llojit te te ardhurave, për periudhen 2027-2029, parashikohen ne vlerat si me poshtë:



Vitet	2027	2028	2029
Ardhurat e veta totale	192,610	193,646	194,077
Ardhura nga taksat vendore	57,592	58,765	58,765
Ardhura nga taksat e ndara	35,284	36,072	36,938
Ardhura nga tarifat vendore	48,268	48,385	48,381
Ardhura te tjera	51,465	50,424	49,993

Të ardhurat e veta, që mbledhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2027-2029 parashikohen që të kenë një trend rritje afersisht 1% për tre vitet e ardhshme.

Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2027-2029 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 21%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 11%, tarifa për pastrimin që zë rreth 18%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 4%, tarifa të tjera ku përfshihen tarifat administrative zëzë rreth 1%.

Shpenzimet janë parashikuar për vitet 2027,2028 dhe 2029 të cilat janë të pasqyruara në projekt vendim.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 4 të rendit të ditës:**Miratohet me 19 vota Pro,zero vota abstenim, 1 votë kundër**,Këshilltarët që votuan Pro piken e 4 të rendit të ditës(Ervis Shimaj,Meliha Zyberaj,Franga Kola.Frano Prenga,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Florin Tanushi,Pjeter Lleshi,Besmir Kapaj,Rita Preçi,Kastriot Shkjau,Ermir Tahiri,Mirela Vasija,Albina Livadhi,Vjollcë Zagani,Gjovana Corri,Sanije Salja,Mark Bisha,Elton Frashnaj).Z.Gjon Marku votoj kundër.

Z.Ervis Shimaj lexon piken 5 të rendit të ditës:Projekt vendim për "Miratimin e pranimit të grantit të akorduar nga UNDP për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, si dhe për miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me VKB nr. 74, datë 23.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Çuka Babani-përgjegjëse e sektorit shërbimit social, Bashkia Vau Dejës e cila Projekti financohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim nr. 01005254, "Leave No One Behind" (ASKUSH TË MOS MBETET PAS) sipas Leter Marrveshjes protokolluar me Nr 4910 Datë 02/07/2026. Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 "Perkujdesi Social" shuma 5,809,547 (Pesë milionë e tetëqind e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) lekë. Kjo nismë synon zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale në territorin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

e Bashkisë Vau Dejës, duke krijuar një shërbim të specializuar, të aksesueshëm dhe të qëndrueshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Qendra do të ofrojë shërbime të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara, të tilla si:shërbime psikologjike; terapi fizike;terapi të folurit;edukim dhe zhvillim;mbështetje psikosociale;punë me familjet dhe prindërit;orientim dhe referim drejt shërbimeve të tjera të nevojshme.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 5 të rendit të ditës:**Miratohet me 20 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**,Këshilltarët që votuan Pro piken e 5 të rendit të ditës(Ervis Shimaj,Meliha Zyberaj,Franga Kola.Frano Prenga,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Florin Tanushi,Pjeter Lleshi,Besmir Kapaj,Rita Preçi,Kastriot Shkjau,Ermir Tahiri,Mirela Vasija,Albina Livadhi,Vjollcë Zagani,Gjovana Corri,Sanije Salja,Mark Bisha,Elton Frashnaj,Gjon Marku).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 6 të rendit të ditës:

Projekt vendim për” Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 "Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Ersilda Preka-specialiste e zyrës juridike, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërinstitucional për përgatitjen dhe përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të botimit "Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025", si material analitik dhe referues për nevojat e saj institucionale. Kjo marrëveshje synon të mundësojë sigurimin e një instrumenti profesional analize, i cili i shërben Bashkisë Vau Dejës në përmirësimin e proceseve të planifikimit dhe vendimmarrjes, në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe në përdorimin e të dhënave të strukturuara për qëllime zhvillimore. Bashkia Vau Dejës angazhohet të bashkëpunojë në sigurimin e informacionit të nevojshëm për realizimin e analizës dhe të përdorë materialin e përfituar në funksion të zhvillimit vendor, planifikimit strategjik dhe aplikimeve për projekte dhe financime. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje. Bashkia Vau Dejës kontribuon me shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë, si financim për përgatitjen e materialit analitik dhe publikimit.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 6 të rendit të ditës:**Miratohet me 20 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**,Këshilltarët që votuan Pro piken e 6 të rendit të ditës(Ervis Shimaj,Meliha Zyberaj,Franga Kola.Frano Prenga,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Florin Tanushi,Pjeter Lleshi,Besmir Kapaj,Rita Preçi,Kastriot Shkjau,Ermir Tahiri,Mirela Vasija,Albina Livadhi,Vjollcë Zagani,Gjovana Corri,Sanije Salja,Mark Bisha,Elton Frashnaj,Gjon Marku).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 7 të rendit të ditës:Projekt vendim për miratimin në parim të dhënies së drejtës së përdorimit të pasurive të paluejtshme shtetërore,sipas gjurmes së projektit të miratuar që bie në territorin e Bashkisë Vau Dejës për zhvillimin të projektit “Parku i integruar eolik dhe fotovoltaiK Kirac”me statusin e “investitorit strategjik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Marinela Deda-Drejtore zyres juridike, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se kërkohet miratim në parim i projekt vendimit sepse procedurat e tjera realizohen në dikgasteret perkatese qeveritare. Propozojmë dhënie në përdorim të pasurive të paluajtshme shtetërore pyje dhe kullota, sipas gjurmës së projektit të miratuar që bie në territorin e Vau Dejës dhe raportit teknik për zhvillimin e projektit "parku i integruar eolik dh fotovoltaik Kirac", me statusin e "investitorit strategjik" Projekti i investimit i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikon të punësojë rreth 124 (njëqind e njëzet e katër) persona.

Vlera e investimit të projektit të investimit "Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kiraç" i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 129,999,988 Euro (njëqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë milion) Euro.

Projekti i investimit parashikon një sistem hibrid gjenerimi të energjisë dhe përkatësisht ndërtimin e një parku të integruar eolik dhe fotovoltaik i cili do të ketë në total një kapacitet të instaluar prej 125 MW. Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen; Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik; Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik; Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik; Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik; Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza.

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim piken 7 të rendit të ditës: **Miratohet me 19 vota Pro, 1 votë abstenim, zero vota kundër**, Këshilltarët që votuan Pro piken e 7 të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Franga Kola, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Florin Tanushi, Pjeter Lleshi, Besmir Kapaj, Rita Preçi, Kastriot Shkja, Ermir Tahiri, Mirela Vasija, Albina Livadhi, Vjollcë Zagani, Gjovana Corri, Sanije Salja, Mark Bisha, Elton Frashnaj). Z. Gjon Marku votoj abstenim.

Z. Ervis Shimaj lexon piken 8 të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e njohjes si posedues jopronarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me Vkm nr. 780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës.

Në këtë moment bëhet pjesë e mbledhjes këshilltari Z. Arsen Mehmeti, i cili kishte njoftuar më heret për vonesën e prezencës. Korumi shkon në 21 këshilltarë prezent.

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Marinela Deda-Drejtore zyres juridike, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se në zbatim të procedurave të ndjekura nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetari të Bashkisë Vau Dejës nr. 08, datë 09.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkuar, për tu njohur si "posedues", "jo pronarë, pasi u njohën me aplikimet e bëra nga subjektet e interesuara në portalin e-albania, mbylljes së korrespondencës zyrtare me ASHK dhe ATP, verifikimit në terren në rastet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

e mungesës së dëshmitarëve, dhe realizimit të afishimit 45 ditor në webin e faqes zyrtare të bashkisë si dhe pranë cdo njësie administrative ku ndodhet prona, paraqiten bashkëngjitur projekt-vendimit relacioni shpjegues përmbledhës për rastet e kualifikuara për fazën e parë të mbylljes së afishimeve publike.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.

Z.Florin Tanushi pyet:Përfituesit a janë banorë të zonave ku kanë përfituar sipëfaqet përkatëse apo jo?

Znj.Marinela Deda përgjigjet se janë 2 kategori, e para janë persona që vërtetohet se kanë ushtruar dhe vazhdojnë të ushtrojnë posedim të vazhdueshëm për të paktën 10 vite mbi pasurinë e palujtshme shtetërore dhe e dyta:janë persona që konsiderohen si posedues jopronarë të pasurisë për të cilën nuk janë pajisur me titull pronësie por vërtetojnë lidhjen e tyre me pasurine me deklarate noteriale.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 8 të rendit të ditës:**Miratohet me 20 vota Pro,zero vota abstenim, 1(një) votë kundër**,Këshilltarët që votuan Pro piken e 8 të rendit të ditës(Ervis Shimaj,Meliha Zyberaj,Franga Kola.Frano Prenga,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Florin Tanushi,Pjeter Lleshi,Besmir Kapaj,Rita Preçi,Kastriot Shkja,Ermir Tahiri,Mirela Vasija,Albina Livadhi,Vjollcë Zagani,Gjovana Corri,Saniye Salja,Mark Bisha,Elton Frashnaj,Arsen Mehmeti).Z.Gjon Marku votoj kundër.

Z.Ervis Shimaj lexon piken 9 të rendit të ditës:

Projekt vendim për"Miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirave publike në territorin Administrativ të Bashkisë Vau Dejës sipas tekstit bashkëlidhur, në zbatim të VKM-së nr 224, datë 01.04.2026, "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Ndoc Baqli-përgjegjës zyres aseteve,Bashkia Vau Dejës i cili spjegon se Rregullorja e re që po ju paraqesim për miratim me projekt vendimin bashkëlidhur, është e ndarë në 11 Krerë, dhe 119 Nene, në të cilat specifikohen të gjitha mënyrat e shfrytëzimit të hapësirës publike rast pas rasti, duke përcaktuar kriteret e qarta, mënyrat e aplikimit, afatet, aktivitetet e lejuara dhe ndalimet, detyrimet financiare, masat administrative për mbulimin e kostove në rast shkelje të lejes, kthimin e saj në gjendjen fillestare pas mbarimit të afatit të shfrytëzimit etj, dhe të gjitha këto, në zbatim të VKM-së nr 224, datë 01.04.2026, (sipërmendur). Konkretisht, një paraqitje e shkurtër e krerëve të Rregullores:

1. Kreu I-rë; Dispozitat e përgjithme.
2. Kreu II-të; Shfrytëzimi i hapësirave publike për Gastronomi, (Bar Restorant), Hoteleri, shërbime të ngjashme dhe rekreative.
3. Kreu III-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike për ekspozimin e një kategorie të kufizuar mallrash jashtë njesisë së tregëtimit.
4. Kreu IV-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike për tregje dhe aktivitete ambulatorë.
5. Kreu V-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e strukturave të lëvizshme.
6. Kreu VI-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e strukturave reklamuese(të tipit light dhe tabelat reklamuese LED).
7. Kreu VII-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike fasada për vendosjen e tabelave reklamuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

8. Kreu VIII-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike për zhvillimin e panairove dhe vendosja e veprave artistike dhe përkujtimore.

9. Kreu IX-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike për aktivitete promovuese, artistike, kulturore, aktivitete politike e të tjera.

10. Kreu X-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike për Plazhet.

11. Kreu XI-të; Shfrytëzimi i hapësirës publike (trotare) gjatë ndërtimit.

Për rrjedhojë në projekt vendim kemi paraqitur për miratim edhe vlerën e propozuar prej 10.000 lekësh, për garancinë financiare që duhet të depozitohet subjekti që kërkon leje nga Bashkia për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim piken 9 të rendit të ditës: **Miratohet me 20 vota Pro, zero vota abstenim, zero vota kundër**, Këshilltarët që votuan Pro piken e 9 të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Franga Kola, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Florin Tanushi, Pjeter Lleshi, Besmir Kapaj, Rita Preçi, Kastriot Shkjau, Ermir Tahiri, Mirela Vasija, Albina Livadhi, Vjollcë Zagani, Gjovana Corri, Sanije Salja, Mark Bisha, Elton Frashnaj, Arsen Mehmeti). Z. Gjon Marku nuk merr pjesë në votim.

Z. Ervis Shimaj lexon piken 10 të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit të znj. Matilda Terziu në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë"

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Dajana Lleshaj-pergjegjese sektorit strehimit social, e cila shpjegon se komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr. 57 me 27.10.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr. 21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr. 33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr. 80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit. Me datë 15.07.2026, u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë të rinovuar dhe kontratës së qirasë noteriale për banoren znj. Matilda Terziu nga Komisioni i Strehimit. Komisioni i Strehimit vendosi kualifikimin e dosjes së znj.

Matilda Terziu, për vazhdimin e përfitimit të subvencionit të qirasë.

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim piken 10 të rendit të ditës: **Miratohet me 21 vota Pro, zero vota abstenim, zero vota kundër**, Këshilltarët që votuan Pro piken e 10 të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Franga Kola, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Ornela Lleshi, Florin Tanushi, Pjeter Lleshi, Besmir Kapaj, Rita Preçi, Kastriot Shkjau, Ermir Tahiri, Mirela Vasija, Albina Livadhi, Vjollcë Zagani, Gjovana Corri, Sanije Salja, Mark Bisha, Elton Frashnaj, Arsen Mehmeti, Gjon Marku).

11. Të ndryshme: Z. Gjon Marku pyet: Para 1 viti kemi miratuar shtesë 2 punonjës për legalizimet, a vazhdon aktiviteti i tyre? Dhe e dyta a është e mundur mbjellja me pemë e unazës së qytetit?

Znj. Marinela Deda përgjigjet: Ne kemi propozuar 2 punonjës për këtë qëllim dhe janë në aktivitet dhe planin e punës e marrin nga ASHK Shkodër, aktualisht kanë përfunduar fshatin Ashtë, Stajkë dhe lagjen Kapedani. Për mbjelljen e pemëve në unazë të qytetit do të parashikohet që të realizohet.

Z. Florin Tanushi ngre shqetesimin për dritat në qytetin Laç. Z. Kristian Shkreli përgjigjet se megjithëse energjia elektrike nuk është në varësi të Bashkisë, ne do interesohemi që të rregullohet ky problem.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Deklarohet e mbyllur mbledhja e radhës muaji Korrik 2026 (30.07.2026) nga Kryetari Këshillit.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

- | | |
|---------------------------|---------------------------|
| 1. <u>Ervis Shimoj</u> | 16. <u>Milhet Zogaj</u> |
| 2. <u>Melike Zyberaj</u> | 17. <u>Gjovanaconi</u> |
| 3. <u>Envera Kalo</u> | 18. <u>Valerije Veqaj</u> |
| 4. <u>Envera Prenga</u> | 19. <u>Mark Bish</u> |
| 5. <u>Majlinda Ndreja</u> | 20. <u>Elton Frashji</u> |
| 6. <u>Ornela Lleshi</u> | 21. <u>Arson Mehmetaj</u> |
| 7. <u>Gjon Marku</u> | 22. _____ |
| 8. <u>Arson Krasni</u> | 23. _____ |
| 9. <u>Peter Ueja</u> | 24. _____ |
| 10. <u>Besmir Koppaj</u> | 25. _____ |
| 11. <u>Rita Praci</u> | 26. _____ |
| 12. <u>Mastriot Shkja</u> | 27. _____ |
| 13. <u>Enver Tohin</u> | 28. _____ |
| 14. <u>Mirela Vasija</u> | 29. _____ |
| 15. <u>Alcina Livadhi</u> | 30. _____ |
| | 31. _____ |